



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11, 12.2 shkronja d) dhe 40 shkronja j) të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, nenit 18 të Ligjit për bashkëpunim ndërkombëtar nr.04/L-010, nenit 6 paragrafi 3 të Rregullores së MAPL-së për procedurën e bashkëpunimit ndërkombëtar nr.0203-1334 të datës 18.12.2012, dhe nenet 14, 15 paragrafi 2.4 si dhe nenin 34 paragrafi 2.10 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.01-020/01-0050862/19, Kuvendi i Komunës së Podujevës, më 03 korrik 2023 vazhdim i mbledhjes së datës 29 qershor 2023, miratoi këtë;

VENDIM

PËR AUTORIZIMIN E KRYETARIT TË KOMUNËS PËR FILLIMIN E KONSULTIMEVE PËR BASHKËPUNIM KOMUNAL NDËRKOMBËTAR – BINJAKËZIM ME KOMUNËN GRUBIŠNO POLJE NË KROACI

Neni 1

z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës së Podujevës të autorizohet për fillimin e konsultimeve për vendosjen e bashkëpunimit komunal ndërkombëtar në formën e binjakëzimit në mes të Komunës së Podujevës dhe Komunës Grubišno Polje në Kroaci.

Neni 2

Të identifikohen interesat e përbashkëta dhe në pajtim reciprok, konform legjislacionit në fuqi, të përgatitet draft Marrëveshja për bashkëpunim të ndërsjellë mes dy Komunave.

Neni 3

Draft Marrëveshja sipas nenit paraprak të këtij vendimi, nënshkruhet nga Kryetari i Komunës së Podujevës, pas vlerësimit të ligjshmërisë nga Ministria e Administrimit të Pushteti Lokal.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe nenit 9 paragrafi 8 të Rregullores (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, me plotësim ndryshimet e bëra me Rregulloren nr.06/2021.

Nr. Prot. 01-016/01-0045389/23
Podujevë, datë: 03 korrik 2023



Kryesuesi i Kuvendit
Hifni Hoxha